

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
DREJTORIA ARSIMIT KULTURES TURIZMIT RINISE DHR SPORTIT

Nr. 4358 Prot.

Rrogozhinë, më 10.10. 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. — /, Datë 10/10/2025.

“PËR SHPALLJEN QYTETAR NDERI PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Z.BAJRAM BEGAJ”

Në shenjë vlerësimi dhe mirënjohje për kontributin e tij të paçmuar në forcimin e unitetit kombëtar, në përfaqësimin me dinjitet të shtetit shqiptar dhe në mbështetje të vazhdueshme ndaj komunitetit tonë lokal.

Në mbështetje të Nenit 8, pika 1,2 ; Nenit 9, pika 1.7, shkronja a ; Nenit 54, shkronja m, të Ligjit 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” i ndryshuar ; me propozim të kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë Z. Edison Memolla dhe me kërkesë të “Komitetit të Veteranëve të Rrogozhinës”

PROPOZOJM

1. Shpalljen Qytetar Nderi Presidentin e Republikës së Shqipërisë Z. Bajram BEGAJ.
2. Ngarkohet për zbatim Drejtoria Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Drejtor AKTRS
Orges TOSKU

KRYETAR
EDISON MEMOLLA

Në mungesë dhe me urdhër

N/Kryetari Bashkisë

Andi PROSHKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
DREJTORIA ARSIMIT KULTURËS TURIZMIT RINISË DHR SPORTIT

Nr. 4358/1 Prot.

Rrogozhinë, më 10.10 2025

RELACION SHPJEGUES
“PËR SHPALLJEN QYTETAR NDERI PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË Z.BAJRAM BEGAJ”

Bajram Begaj ka lindur më 20 mars 1967 në fshatin Gosë, Rrogozhinë.

Ai u diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë në vitin 1989 dhe u bë mjek aktiv në vitin 1998. Pasi ka përfunduar doktoraturën profesionale mban titullin “Profesor i Asociuar” në Mjekësi.

Gjatë karrierës së tij ushtarake 31-vjeçare, Begaj ka marrë pjesë në seminare të shumta trajnimi dhe ka përfunduar kurse në Siguri dhe Mbrojtje, Shkollën e Avancuar Pasuniversitare të Mjekësisë, Specializim Pasuniversitar në Gastrohepatologji, Kursin e Menaxhimit Spitalor dhe Kursin Strategjik të Udhëheqjes Mjekësore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një kurs specializimi në mjekësi dhe një kurs shëndetësor në Greqi.

Z.Bajram Begaj ka shërbyer më parë si Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Forcat e Armatosura Shqiptare. Ai gjithashtu ka mbajtur poste të tjera të ndryshme duke përfshirë: Shef i Njesisë Mjekësore Ushtarake, Drejtor i Spitalit Ushtarak, Drejtor i Inspektoriatit Shëndetësor, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Shqiptare.

Më 3 qershor i vitit 2022, Z.Bajram Begaj u propozua zyrtarisht nga Partia Socialiste në pushtet si kandidat për raundin e katërt të zgjedhjeve presidenciale të vitit 2022 ku edhe aktualist e mban si post. Begaj është presidenti i 5 (pestë) në historinë e Shqipërisë me formim ushtarak, pas Ahmet Zogut, Ramiz Alisë, Alfred Moisiut dhe Bujar Nishanit dhe i 11 (Njimbëdhjeti) që nga koha që Shqipëria ka pasur president.

Z.Bajram Begaj është i martuar me Znj.Armanda Begajn, me të cilën ka dy djem, Dorian dhe Klajdi Begaj.

Drejtor Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve

Orges TOSKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KOMITETI I VETERANËVE

Nr. 14/1 Prot.

Rrogozhinë, më 3. 10 .2025

KËRKESË

DREJTUAR : KËSHILLI BASHKIAK RROGOZHINË

**PER DIJENI : Z. EDISON MEMOLLA
KRYETAR I BASHKISË**

RROGOZHINË

Me rastin e 81 vjetorit , çlirimit të qytetit Rrogozhinë datë **13/11/2025**. Komiteti i veteraneve dhe Bashkia organizojnë festën e kësaj date historike për çlirimin e qytetit me 13 Nëntor 1944 nga forcat partizane për largimin nga qyteti ynë dhe rrethinat, pushtuesit e huaj Gjermanë dhe Italianë .


Për nder të kësaj date historike propozojmë që SH.T.Z. BAJRAM RESHIT BEGAJ si djalë i lindur dhe rritur këtu ne qytetin tonë. Sot President i Republikës së Shqipërisë, T'i jepet titulli QYTETAR NDERI I RROGOZHINËS.

Shpresojmë që kërkesa jonë të merret në konsideratë.

KONCEPTOI
Sek: Sabri MINGAJ



Kryetari: Ylli THARTORI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
DREJTORIA ARSIMIT KULTURES TURIZMIT RINISE DHR SPORTIT

Nr. 4821 Prot.

Rrogozhinë, më 07-11-2025

Lënda: Jeta, Karriera, Veprat e Presidentit Të Republikës së Shqipërisë Z. Bajram BEGAJ me motivacionin “PËR SHPALLJEN QYTETAR” të Rrogozhinës

Drejtuar: Këshillit Bashkiak. (Komisionit për dhënien e titujve)

Në mbështetje të Nenit 8, pika 1,2 ; Nenit 9, pika 1.7, shkronja a ; Nenit 54, shkronja m, të Ligjit 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” i ndryshuar ; me propozim të kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë Z. Edison Memolla dhe me kërkesë të “Komitetit të Veteranëve të Rrogozhinës” si dhe praktikës së nderimit të personaliteteve që kanë kontribuar në interes publik, po ju paraqesim për shqyrtim jetën, karrierën, veprat të Z. Bajram Begaj, President i Republikës së Shqipërisë për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” të Bashkisë Rrogozhinë.

Të dhëna biografike dhe profesionale

Z. Bajram Begaj lindi më 20 mars 1967 në Gosë, Rrogozhinë. Karriera e tij profesionale është e lidhur drejtpërdrejt me shërbimin ndaj vendit, si brenda strukturave të Forcave të Armatosura, ashtu edhe në drejtimin e institucioneve të larta të shtetit.

Ai ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, me profil mjekësi ushtarake, duke u specializuar si mjek infeksionist dhe duke zhvilluar kualifikime të shumfishta brenda dhe jashtë vendit.

Karriera në Forcat e Armatosura

Gjatë rrugëtimit të tij ushtarak ka mbajtur funksione të larta komanduese dhe administrative:

- Shef i Qendrës Spitalore Universitare Ushtarake.
 - Drejtor i Inspektoratit të Forcave të Armatosura.
 - Komandant i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
- duke arritur gradën Gjeneral Major.

Në këto detyra ai është vlerësuar për profesionalizëm dhe kontribut në modernizimin e strukturave shëndetësore dhe ushtarake, sidomos në periudhën e pandemisë COVID-19.



President i Republikës së Shqipërisë

Në qershor 2022, Bajram Begaj u zgjodh President i Republikës së Shqipërisë, duke u bërë i pari president në historinë e vendit me formim karriere ushtarake-mjekësore.

Arsyetimi për nderim

Bajram Begaj përfaqëson një figurë të lartë kombëtare me kontribut të çmuar në shërbim të institucioneve të shtetit, forcimit të imazhit të Shqipërisë dhe përfaqësimit ndërkombëtar të vendit.

PROPOZIM

Në bazë të argumenteve të mësipërme, propozohet:

- Miratimi nga Këshilli Bashkiak i titullit “Qytetar Nderi” të Rrogozhinës Z. Bajram Begaj – President i Republikës së Shqipërisë.

Drejtore Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve

Orges TOSKU



2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4358/2 Prot.

Rrogozhinë, më 13.10.2025

LËNDA : Shqyrtim dhe vlerësim të propozimit për dhënien e titullit, “Qytetar Nderi i Rrogozhinës”, Presidentit të Republikës SH.T.Z. Bajram Begaj.

DREJTUAR : Komisionit Këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit për Bashkinë Rrogozhinë.

- znj .	Fatmira Thartori	Kryetare
- znj .	Silvana Aliu	Zv. Kryetare
- z .	Enver Memolla	Anëtar
- z .	Indrit Dedej	Anëtar
- z .	Lulzim Hasa	Anëtar

Të nderuar,

Duke ju uruar punë të mbarë, ju bëjmë me dije që në sekretarinë e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë sot me datë 13.10.2025 është depozituar një propozim për dhënien e titullit Qytetar Nderi i Rrogozhinës”, Presidentit të Republikës SH.T.Z. Bajram Begaj.

Për sa më sipër duke qenë se çdo propozim për dhënien e titujve vendorë duhet t’i paraqitet për shqyrtim dhe vlerësim komisionit tuaj, bashkëngjitur po ju dërgojmë dokumentet si më poshtë :

1. Kërkesë për dhënie titulli qytetar nderi Presidentit të Republikës SH.T.Z. Bajram Begaj nga Komiteti i Veteranëve shkresa me Nr.14/1.Prot datë 03.10.2025.
2. Projekt-vendim me shkresë Nr.4358.Prot datë 10.10.2025 “Për shpalljen Qytetar Nderi Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Bajram Begaj”, propozuar nga Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë dhe drejtori i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve pranë bashkisë.
3. Relacion shpjegues për projektvendimin me të njëjtin objekt me shkresën Nr.4358/1.Prot datë 10.10.2025 nga drejtori i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve pranë bashkisë Rrogozhinë.

Për sa më lart referuar legjislacionit në fuqi, kërkojmë nga ana juaj vlerësimin e këtij propozimi dhe vendimi i marrë të përcillet drejt këshillit bashkiak për procedura të mëtejshme.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email: brrrogozhine@gmail.com

Nr. 5067/v0
Dt. 21.11.2023

Kerkese

Drejtuar. Kryetares keshillit bashkiak.

Drejtore arsimi ne bashkin Rrogozhine.

Drejtuar kryetarit Edison Memolla

Lenda :Kerkese per informacion mbi materiale shkollore.

Ju drejtohem me kete kerkese per te marre informacion zyrtare lidhur me materiale shkollore dhe furnizimet e siguruar per institucionet arsimore ne varesi te bashkise.

Duke ditur se keshilli ka detyrim te ushtroje kontroll dhe monitorimet mbi cilesine dhe shperndarjen e materialeve didaktive, ju lutem te Na vihet ne dispozicion informacioni i meposhme:

1. Lista e plote e materialeve shkollore pajisur per vitin shkollos 2025.
2. Institucionet arsimore qe kane perfituar keto materiale.
3. Sasine e materialeve te shperndara per cdo shkolle dhe afati i furnizimit me cdo procedure te ndjekur.

Anetare e keshillit bashkiak

Silvana Aliu



Nr. 50663 vet
21.11.2023

Kerkese.

Drejtuar Keshilli bashkiak

Lenda. Kerkese per ngritje komisioni per verifikimet dhe transparenc mbi proceset e punesimit ne bashkin.

Drejtuar: Kryetarit Edison Memolla.

E nderuar. Kryetares e keshilli bashkiak ne cilesine e kryetares se opozites ju parashtroj kete kerkese

per ngritjen e nje komisioni qe sigurone trasparencen dhe barazine per proceset e punesimit ne institucionet Varese te bashkise.

Qelimi i ketij komisioni eshte te.

1. MONitoroje zbatimin e procedurave ligjore per punesimet ne bashki dhe nstitucionet varese.

2. Garantoje qe rekrutimet te bazohen ne merite, profesionalizem.

3. te pergatise nje raport per keshillin bashkiak me gjetje dhe rekomandime perkatese.

Ky komisioni do te ndihmonte ne forcimin e besimit te qytetareve ndaj institucioneve vendore dhe do te siguronte trajtimin e barabarte per cdo aplikante.

Antare keshillit..... SILVANA ALIU

